



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, Rregulloren nr. 01/155-352 për Shërbime Publike Komunale dhe nenin 64.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, si dhe duke marrë parasysh edhe kërkesat dhe nevojat e bizneseve dhe qytetarëve për ofrimin e mundësive për qarkullim me automjete për nevoja të furnizimit të tyre, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. 10-345/03-0020522/22, datë 21 mars 2022 për lejimin e hyrjes dhe qarkullimit me automjete në Bulevardin/Sheshin e qytetit me qëllim të furnizimit me mallra nga subjektet afariste të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre biznesore në lokalet dhe objektet përgjatë hapësirës së Bulevardit,

përkatësisht neni 2 i Vendimit bazë riformulohet si në vijim:

Hyrja dhe qarkullimi brenda hapësirës së Bulevardit të qytetit sipas nenit 1 të këtij vendimi lejohet nga ora 06:00 deri më 09:00 të mëngjesit dhe atë shtatë (7) ditë në javë.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, ndërsa pjesët tjera të Vendimit bazë mbeten të pandryshuara.

Me këtë vendim njoftohen;

Subjektet Afariste përgjatë Bulevardit/Sheshit të qytetit, Drejtoria e Inspeksionit dhe Policia e Kosovës – Stacioni Podujevë.

Nr.prot: 10-352/01-0015049/23
Podujevë, datë: 22.02.2023



Drejtori
Babri Selimi